



KONTRATE DHURIMI

Ne Vlore, sot me date 01/12/1997, para meje noteres Xhoziana Laze u paraqiten personalisht shtetasit:

1. Feçor Lulaj, i biri i Arshiut, i datlindjes 1940, lindur dhe banues ne Vlore, ne cilesine e ortakut dhe dhenesit te pelqimit per dhurimin. - -

2. Mirela Lulaj, e bija e Beges, e datlindjes 1968, lindur dhe banese ne Vlore ne cilesine e dhurueses se kuotave te kapitalit themeltar. - -

3. Besnik Lulaj, i biri i Feçorit, i datlindjes 19... , lindur dhe banues ne Vlore, ne cilesine e pranuesit te dhurimit te kuotave te kapitalit themeltar.

Te siperpermendurit jane person madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, te pa njohur prej meje, por per identifikimin e te cileve u sigurova sipas ligjes, te cilet kerkuan redaktimin dhe legalizimin e kontrates se dhurimit si me poshte:

Mirela Lulaj dhe Feçor Lulaj jane ortakje te shoqerise "Miri "sh.p.k. me kapital themeltar prej 100.000 lekesh, ne raportet 49 dhe 51 perqint perkatesisht dhe ne kete menyre Mirela Lulaj zoteron 49 kuota me vlere gjithsej 49.000 (dyzetebentemije) leke te reja. -

Me vendimin Nr.1, date 01/12/1997 te Asamblese se Ortakeve, mbeshtetur ne nenet 47 dhe 60 te Ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe nenin 7 te Statutit, eshte vendosur qe Ortakja Mirela Lulaj te largohet me vullnetin e saj nga Shoqeria dhe kuotat e saja te kapitalit t'ja dhuroje bashkshortit te saj Besnik Lulaj, i cili behet ortak i Shoqerise. Prandaj ne mbeshtetje te vendimit te mesiperme, me ane te kesaj kontrate, Mirela Lulaj i dhuron keto kuota Besnik Lulaj pa kundershperblim. Pas nenshkrimit te kesaj kontrate ne pranine e noterit, Besnik Lulaj behet pronar i 49% te kuotave te kapitalit, ose te 49 (dyzetebentemije) leke te reja. - - - - -

Kontrata e mesiperme behet edhe ne prani te ortakut tjeter te shoqerise Feçor Lulaj, i cili me kete rast ka dhene pelqimin e tij. - - -

Teksti i kesaj kontrate, pasi u lexua nga palet dhe pane se eshte ne perputhje me vullnetin e tyre, nenshkruhet pa vajtje ne pranine time. Une Noterja, pasi pash se palet e nenshkruan kontraten me vullnetin e tyre te lire e vertetova dhe e regjistrova. - - -

PALET KONTRAKTUESE

DHURUESJA
/Mirela Lulaj/

DHA PELQIMIN
/Feçor Lulaj/

PRANUESI I DHURIMIT
/Besnik Lulaj/

NOTERJA